



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Përmbyrje/Prodato Received/Delivery	15.05.2023	3	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
OKINSHICK	4241/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.519/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Sabile Avdyli - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 519/2023 të datës 16.03.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 3 , nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa numër A.nr.519/2023 e datës 16.03.2023 e parashtruar nga ankuesi

II.ANULOHET Vërejtja e datës 03.03.2023 e shqiptuar nga Udhëheqësi i drejtëpërdrejt i ankuesit.

III.Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë , që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunësit Astrit Hyseni si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të anuluar si në pikën II.

IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për TI dhe Shërbime Logjistike" në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të emërimit të datës 08.10.2014, më datë 16.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit për shqiptimin e masës disiplinore, Vërejtje e datës 03.03.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek organi i punësimit, ndërsa ky i fundit më datë 12.04.2023, ka dërguar përgjigje në ankesë me numër protokoli 3482/2023 së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 2737/2023 të datës 16.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për shtesa në pagë; E-mail zyrtar i datës 03.03.2023; E-mail zyrtar i datës 15.03.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 30.03 të Divizionit 3.2023; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 12.04.2023 me numër protokoli 3482/2023 bashkë me shkresat e lëndës; Ndryshimi dhe Plotësimi i aktit të emërimit i datës 08.10.2014; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për IT dhe Shërbime Logjistike i datës 08.10.2014; Kërkesë për shtesa mbi pagën bazë përmes e-mailit zyrtar të datës 03.03.2023; E-mail zyrtar i datës 20.02.2023; E-mail zyrtar i datës 15.02.2023-Kërkesë për shtesa mbi pagën bazë; Kërkesë për shtesa mbi pagën bazë e datës 15.02.2023 nga ankuesi për Zv.Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; E-mail zyrtar i datës 20.02.2023 -kërkesë për shtesa mbi pagën bazë; Vendimi A.nr.223/2021 i datës 16.04.2021 me numër protokoli 1823/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 22.01.2023 me notë 3.2 dhe Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 01.02.2021 me notë 3.7.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi së ankesa e ankuesit është e **bazuar, sepse:**

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë Drejtori për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndaj ankuesit i cili mbanë pozitën : "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Logjistike", me datë 03.03.2023 përmes e-mailit zyrtar i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetimin se i njëjti me datën 15.02.2023 dhe 16.02.2023 përmes e-mailave zyrtar që ju është dërguar zyrtarëve përkatës me ç'rast ka bërë shkelje dhe tejkalim të kompetencave. Ankuesi z.Astrit Hyseni me datën 15.02.2023 ka parashtruar dy kërkesa njërenë në përmesë e-mailit dhe tjetren fizikisht për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë për shtesa në pagën bazë, duke kërkuar të njoftohet se a i është përcjellë emri tek Komisioni i formuar për ndarjen e shtesave në pagë, por i njëjti nuk ka marrë asnjë përgjigje as me shkrim as me e-mail e as gojarishtë. Për mospërgjigje nga kërkesat e parashtruara me datën 20.02.2023 përmes e-mailit ka parashtruar prap kërkesë për shtesa në pagë



për stafin udhëheqës të Ministrisë ku ndër tjera ka kërkuar :*"të nderuar, për kundër njoftimeve javën e kaluar për kundër kërkesave qoftë gojore qoftë me shkrim drejtuar juve si udhëheqës me të lartë të këtij institucioni, pas miratimit të rregulloreve nga ana e Qeverisë së Kosovës, një gjë e tillë nuk është respektuar dhe nuk është përfillur nga ana juaj, për të dërguar emrin tim tek komisioni i cili do të vlerësonte se a më takojnë edhe mua shtesat apo jo, duke ju thënë se nga ky moment ju njoftoj që do ngritet Kallëzim Penal për gjithë ju që po ju drejtohem me këtë e-mail, sepse ndaj ankuesit pretendohet se është bërë shkelje e të drejtave të njeriut....."*
.Po të njëjten ditë mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë i ankuesit i është përgjigjur ankuesit se me rastin e kërkesave që keni bërë përmes e-malit ju keni bërë tejkalim të kompetencave se nuk më jeni drejtuar mua dhe njihërit potencon se *"në cilësinë e drejtorit të DSHP-së, unë kam dërguar emrat e zyrtarëve nga departamenti që kam konsideruar se i plotësojnë kriteret për shtesa në paga, në bazë të "Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik"* . Ndërsa ankuesin nuk e kanë njoftuar se a është edhe emri i tij në atë listë edhe pse ka bërë kërkesa të vazhdueshme për shtesa në pagë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se shqiptimi i masës disiplinore *"Vërejtje"*, nga Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë, përmban shkelje të dispozitave procedurale duke pretenduar se vërejtja e datës 20.02.2023 është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, duke i propozuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që ti aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet *"Vërejtja"* e datës 20.02.2023.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vërejtjes së shqiptuar nga Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, konstaton se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka bërë vlerësim të drejtë të provave mbi bazë të cilave është vendosur për masën e shqiptuar e mbi këtë bazë edhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale në këtë rast, nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 dhe nenit 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se *"4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar"*. Andaj kolegji i këshillit konstaton se shqiptimi i masës disiplinore vërejtje është jo e bazuar në legjisllacionin në fuqi nga se në asnjë mënyrë nuk është argumentue fakti se ankuesi ka shkelë dispozitën e nenit 46 paragrafi 4.3, përkatësisht me asnjë provë nuk është argumentuar se është përgjegjës ankuesi sa i përket kësaj dispozite së cilës i referohet ankuesi, rrjedhimisht nuk është konstatuar se është shkaktuar ndonjë pasojë për institucionin përkatës si rezultat i këtyre komunikimeve zyrtare, andaj mbi këtë bazë kjo vërejtje përveç asaj që u tha më lartë gjithashtu kjo shkresë nuk i ka elementet e një akti administrativë të cilat janë të domosdoshme ashtu siç parashihet në Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 47 paragrafi 1... ,andaj mbi bazë të asaj që u tha më lartë dhe nëse i referohemi Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenit 48 paragrafi 2 ku parashihet *"2.Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave mbi bazën e asaj që u potencua më lartë konstaton se Vërejtja e datës 20.02.2023 e shqiptuar nga Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë në Ministrinë e Industrisë,

Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë kjo vërejtje është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkaqet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, bazuar në arsyetimin e sipërm si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.519/2023, datë 15/05/2023.

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë
- Udhëheqëses së Personelit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

